



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:029077
Datë: 21.05.2024
Numri i dokumentit: 05757717

AA.nr.458/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Delushe Halimi kryetare e kolegjit, Ramiz Kuqi dhe Hajriz Hoti, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit B.Sh., nga P., me adresë në rrugën "...", nr....., kundër të paditurit Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK), në Prishtinë, të cilin e përfaqëson Çlirim Zeka, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative A.nr.298/2022, i datës 07.06.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 21.05.2024, merr këtë;

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit B.Sh., e datës 14.06.2023, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.298/2022 i datës 07.06.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin e ankimuar, në pikën I të dispozitivit ka vendosur: Refuzohet si e pabazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit B.Sh., nga P., me adresë në rrugën "...", nr....., me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi A.nr.... i datës ... i të paditurit Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Në pikën II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar paditësi, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të; vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit të aprovoj ankesën e paditësit dhe të anuloj Aktgjykimin A.nr.298/2022 të datës 07.06.2023, të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe çështjen e kthen në rigjykim ose të ndryshoj aktgjykimin.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e lëndës, Aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49, të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), dhe neni 194 i LPK-së, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjen se;

Ankesa është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me Vendimin A.nr.... i datës ..., e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën me numër A.nr.151/2020 e datës 28.05.2020 e parashtruar nga ankuesi B.Sh. dhe ka mbet në fuqi vendimi me nr.... i datës ..., i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së P. .

Paditësi, i pa kënaqur me këtë vendim ka ushtruar padi në gjykatë, kundër të paditurit Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës, duke pretenduar se vendimi është jo ligjor, me propozimin që i njëjti të anulohet.

Gjykata e shkallës së parë, në këtë çështje ka mbajtur seancë të shqyrtimit kryesor, më datë 07.06.2023, në prani të palëve ndërgjyqëse dhe pas administrimit të provave si dhe shkresave tjera të lëndës merr aktgjykimin e ankimuar me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, në arsyetim ndër të tjera ka theksuar se: procedura administrative e zhvilluar tek organi i paditur është kryer në përputhje të plotë me nenin 132 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Po ashtu gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe me të drejtë janë trajtuar të gjitha pretendimet ankimore të paditësit.

Gjykata konstatoi se vendimi i të paditurit nuk është në kundërshtim me nenin 48 të LPA-së, për faktin që nga vlerësimi dhe analizimi i pjesës arsyetuese, gjykata erdhi në përfundim se në pjesën arsyetuese janë dhënë sqarime të detajuara edhe të dispozitave ligjore mbi të cilat është marrë vendimin i kundërshtuar me padi. Në këtë drejtim, gjykata gjeti se vendimi i atakuar i marrë nga i padituri është në përputhje të plotë me nenin 47 dhe nenin 48 të LPPA-së.

Gjykata vërtetoi gjetjet e të paditurit në vendimin e kontestuar me të cilat me të drejtë ka konstatuar se pretendimi ankimor i paditësit se të njëjtit është dashur ti shqiptohet një masë më e lehtë e jo menjëherë ti ndërpritet marrëdhënia e punës, është i paqëndrueshëm sepse Komisioni Disiplinor i Komunës së Pejës me rastin e marrjes së Vendimit me numër ... të datës ..., duke u bazuar në Aktgjykimin DKR.P.nr.47/2018 të datës 19.12.2019 të Gjykatës Themelore/Departamenti për Krime të Rënda në Pejë ka shpallur fajtor ankuesin B.Sh. pasi që ka kryer veprën penale të mashtrimit nga neni 335, paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPK-së dhe e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) viteve dhe me dënim me gjobë në të holla në shumën prej dyqind (200) Euro, mirëpo dënimi me burg, fare nuk ka për tu ekzekutuar me kusht që i akuzuari në afat prej një (1) viti nuk do të kryer vepër të re penale”, dhe se Komisioni Disiplinor ka vepruar drejtë pasi që është vërtetuar se ankuesi me veprimet e tij lidhur me paraqitjen e rreme të fakteve dhe falsifikimin e dokumenteve ka bërë shkelje të detyrave të punës.

Gjykata konstatoi se organi i paditur drejtë ka vërtetuar referimet e Komisionit disiplinor, dhe atë mbi bazë të nenit 63, paragrafi 4 të Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës i cili përcakton si në vijim: *“Neni 63 Përgjegjësitë- 4. Nëse nëpunësi civil shpallet fajtor dhe dënohet për kryerje të veprës penale, autoritetet kompetente administrative detyrohen që nga ato elemente të vendimit të gjykatës kompetente, që përbëjnë shkelje të parimeve dhe të rregullave administrative, duhet të urdhërojnë shkarkimin e nëpunësit civil”* dhe nenin 66, paragrafin 1 të Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton si në vijim: *“Neni 66 Kushtet e zbatimit të masave disiplinore 1. Masat disiplinore zbatohen në mënyrë graduale dhe në proporcion me pasojat dhe dëmet e shkaktuar nga sjellja e nëpunësit civil. Rastet e shkeljeve jashtëzakonisht të rënda përcaktohen me akt nënligjor”*.

Qëndrimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në prova dhe ligj në tërësi e aprovon edhe Kolegji i Gjykatës së Apelit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje Gjykata e shkallës së dytë i vlerëson sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së. Kolegji vlerëson se Gjykata e shkallës së parë, sipas kompetencës si në vështrim të nenit 9 dhe 44 të LKA-së, në mënyrë të drejtë ka shqyrtuar dhe vlerësuar ligjshmërinë e Vendimit të KPMSHCK, të atakuar me padi, i cili vendim i ka të përmbledhura argumentet në të cilat është bazuar në arsyetimin e tij, ku janë dhënë arsye të mjaftueshme mbi faktet vendimtare në të cilat është bazuar, e të cilat Gjykata e Apelit njëjtë si gjykata e shkallës së parë, i aprovon si të drejta dhe ligjore.

Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të paditurës si në vështrim të nenit 9, dhe 44 të LKA, në seancën e shqyrtimit kryesor, si në vështrim të nenit 38.1.2 të LKA, pas administrimit të provave, dhe në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, vendos drejtë me lënien në fuqi të vendimit të organit të paditur, si vendim i drejtë dhe ligjor i nxjerrë në bazë të dispozitave ligjore të LPPA, dhe ligjit material, ku pa dyshim është vërtetuar se pretendimet e paditësit janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, pasi që në rastin konkret kemi të bëjmë me shqiptimin e dënimit me burgim ndaj paditësit, ku i njëjti ka bërë shkelje të rënda të detyrave të punës, pra sipas Aktgjykimit DKR.P.nr.47/2018 të datës 19.12.2019 të Gjykatës Themelore/Departamenti për Krime të Rënda në Pejë, i njëjti është shpallur fajtor për veprën penale të mashtrimit nga neni 335, paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPK-së dhe është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) viteve dhe me dënim me gjobë në të holla në shumën prej dyqind (200) Euro, mirëpo dënimi me burg, fare nuk ka për tu ekzekutuar me kusht që i akuzuari në afat prej një (1) viti nuk do të kryer vepër të re penale”, aktgjykimi me të cilin është shpallë fajtor tani paditësi për veprën penale mashtrim nga neni 335 par.3 lidhur me paragrafin 1 të KPK-së dhe të njëjtin e lidh direkt me veprimet e ndërmarra brenda detyrave të tij të punës. Andaj duke u bazuar në nenin 63 par.4 të Ligjit për Shërbimin Civil, me të cilin përcaktohet se: “*Nëse nëpunësi civil shpallet fajtor dhe dënohet për kryerje të veprës penale, autoritetet kompetente administrative detyrohen që nga ato elemente të vendimit të gjykatës kompetente, që përbëjnë shkelje të parimeve dhe të rregullave administrative, duhet të urdhërojnë shkarkimin e nëpunësit civil*”, ndërsa neni 66 përcakton se: “*1. Masat disiplinore zbatohen në mënyrë graduale dhe në proporcion me pasojat dhe dëmet e shkaktuar nga sjellja e nëpunësit civil. Rastet e shkeljeve jashtëzakonisht të rënda përcaktohen me akt nënligjor. 2. Shkeljet e detyrave të punës ndahen në: shkelje të lehta dhe shkelje të rënda – serioze, të cilat do të rregullohen me akt nënligjor. 3. Për shkelje të lehta shqiptohen masat disiplinore si në vijim: 3.1. vërejtje gojore; 3.2. vërejtje me shkrim që vendoset në dosjen personale të shërbyesit civil. 4. Për shkelje të rënda – serioze shqiptohen masat disiplinore si në vijim : 4.1. pezullimi nga puna dhe ndalimi i 1/3 të rrogës për një periudhë deri në dy (2) muaj nga komisioni disiplinor pas kërkesës nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë; 4.2. largimi nga zyra dhe transferimi në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalimi i gradimit deri në pesë (5) vjet nga komisioni disiplinor; 4.3. ndërprerja e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil nga komisioni disiplinor. Gjithashtu me nenin 67 par.1 pika 1.2 me të cilin përcaktohet se: “1. Vetëm këto masa disiplinore mund të zbatohen për shkeljen e detyrave të përcaktuara me këtë ligj: 1.2. për shkelje të rëndë aplikohen masat disiplinore në vijim: 1.2.1. pezullimi parandalues me pagesë deri në tre (3) muaj në pritje të një hetimi i cili duhet të propozohet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe miratohet nga organi përgjegjës për menaxhimin e personelit në institucion. 1.2.2. pezullimi i detyrave dhe ndalimi i 1/3 të rrogës për një periudhë deri në dy (2) muaj nga komisioni disiplinor pas kërkesës nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë; 1.2.3. largimi nga zyra dhe transferimi në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalimi i gradimit deri në pesë (5) vjet nga komisioni disiplinor; 1.2.4. ndërprerja e marrëdhënies së punës në shërbimin civil nga*

komisioni disiplinor, pa dëmtuar apo reduktuar të drejtën në pension; 1.2.5. pensionimi i parakohshëm për nëpunësit civilë të cilëve u kanë mbetur edhe dy (2) vjet deri në datën e pensionimit. Andaj bazuar në provat e administruara në gjykatën e shkallës së parë, është vendosur drejt dhe janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për faktet vendimtare dhe bazat ligjore në të cilat bazohet aktgjykimi për refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit, sepse pa dyshim vërtetohet se, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur me refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit.

Sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike Kolegji konsideron se gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit, ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit, në padi janë të pabazuara, sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, meqë vendimi i organit administrativ është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi. Sepse paditësi me asnjë provë nuk i vërteton pretendimet e tij, ndërsa provat e prezantuara nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative juridike.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje të konstatuar, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, se ankesa nuk rezulton nga faktet e vërtetuara dhe provat e vlerësuara andaj thënie e ankesës ky kolegji nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi se pretendimet ankimore ishin pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë.

Nga të lartë cekurat e si në vështrim të nenit 49 të LKA, dhe neni 200 i Ligjit për procedurën kontestimore, i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.458/2023, datë 21.05.2024

Kryetare e kolegjit,
Delushe Halimi